



## **NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE**

### **PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË NË FAKULTETIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE INOVACIONIT TË UNIVERSITETIT “LUARASI” PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Universiteti “Luarasi”, në zbatim të Urdhrit të Rektorit Nr. 1, datë 14.7.2021 “Për punësimin e personelit akademik me kohë të plote për vitin akademik 2021 – 2022”, shpall njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës Përgjegjës i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit:

#### **Përshkrimi i vendit të punës**

Personeli akademik me kohë të plotë që do të punësohet do të anagazhohet në mësimdhënie në programet ciklit të parë dhe të dytë, në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit, pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Gjithashtu do të mbulojë të gjitha detyrat e tjera administrative që përfshin posti i Përgjegjës të Departamentit.

#### **Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët**

- Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të jetë i aftë të garantoj standardin e cilësisë dhe efikasitetin në mësimdhënie.
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe studentët;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jetë person nën hetim;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- Të ketë eksperiencë në punë.

#### **Kriteret bazë:**

1. Të jetë diplomuar në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe të tjerave të ngjashme.
2. Duhet të zotërojë të paktën gradën shkencore “Doktor i Shkencave”.
3. Të ketë përvojë akademike ose profesionale, brënda ose jashtë vendit.
4. Të përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

#### **Dokumentacioni i kërkuar**

- 1) Kërkesë me shkrim drejtuar Universitetit “Luarasi”
- 2) Fotokopje të diplomave dhe të certifikatës/ave së notave të noterizuar/a. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- 3) Fotokopje të dëshmimeve e kualifikimeve të ndryshme, si dhe të publikimeve e të pjesëmarrjeve në Konferenca Shkencore.
- 4) Fotokopje të kartës së identitetit, ose ndonjë dokumenti tjetër identifikimi;
- 5) Fotokopje të librezës së punës, nëse ka, apo vetëdeklarim punësimi ose vetëdeklarim si i punësuar;
- 6) Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së zotërimit të gjuhës së huaj;

Skualifikohen dhe nuk kalojnë në fazën e dytë, thirrjen në intervistë, ata aplikantë të cilët paraqesin dokumenta të pa noterizuara, ose kanë mangësi në dokumentacionin e kërkuar.

Dokumentat duhet të dorëzohen përmes shërbimit postar ose dorazi në adresën:

**Universiteti “Luarasi”, Tiranë.**

**Adresa: Rruga e Elbasanit, Nd. 59, H.1**

**Njësia Administrative Nr.2, Kodi Postar 1010**

**Tiranë, Shqipëri**

**Aplikim për Staf Akademik në Universitetin “Luarasi”**

Afati për dorëzimin e dokumentave është nga deri më **datë \_\_.09.2021** .

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni:

Zyrën e Burimeve Njerëzore të Universitetit “Luarasi” në adresën:

Email: [gersilda.malaj@luarasi-univ.edu.al](mailto:gर्सilda.malaj@luarasi-univ.edu.al) ose [info@luarasi-univ.edu.al](mailto:info@luarasi-univ.edu.al)

Mob: + 355688030950